



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

## **KOMISIONI KOMUNAL I AKSIONARËVE I NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE** **“Eko-Llapi “ SH.A. PODUJEVË**

Bazuar në nenin 5 paragrafi 2 ,nenet 16 dhe 17 të ligjit për Ndermarrjet Publike nr.03/L-087,dhe ndryshim plotësimet përkatëse të bëra me Ligjin nr.04./L-111 dhe Ligjin 05/L-009,neni 3 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ 03/2009 për mënyren e përfaqësimit të Komunave në Bordet e Drejtorëve të Ndërmarrjeve Publike Lokale .Komisioni Komunal i Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi “ SH.A.Podujevë, i ngritur me Vendimin e Kuvendit të Komunës nr.prot.01-016/01-0079532/23 të datës 31.10.2023 dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës nr.prot 02-020/04-0083474/23 të datës 22.11.2023, në mbledhjen e mbajtur më 01.12.2023, vendosi të shpall këtë:

### **KONKURS**

**Për zgjedhjen e 4 (katër) anëtarëve të Bordit të Drejtorëve**  
**të Ndërmarrjes Publike Lokale**  
**“Eko-Llapi “ Sh.A. Podujevë**

#### **Mandati**

Mandati i anëtarëve të Bordit është në përputhje me Ligjin për Ndermarrjet Publike nr.03/L-087

#### **Kompensimi**

Kompensimi i anëtarëve të Bordit do të bëhet në pajtim me dispozitat e nenit 20 të Ligjit për Ndermarrjet Publike nr.03/L-087 dhe dispozitat tjera përkatëse ligjore.

#### **Përbërja**

Përbërja e Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi “ Sh.A. Podujevë, duhet të jetë në harmoni me Ligjin për Barazi Gjinore.

#### **KUALIFIKIMET DHE PËRGATITJA PROFESIONALE**

- Të jetë person që ka integritet dhe të mos ketë çfarëdo shkelje financiare ndaj personave tjerë fizik dhe juridik:
- Të ketë përgatitje superiore :
- Të ketë së paku 5 vite përvojë pune në nivel të lartë të menaxhimit në fushën : administrim i biznesit ,financa të korporatave ,menaxhim të thesarit ,menaxhim të bankave ,konsulent

në biznes ose industri ose nga fusha tjera të shkencave,të ketë qenë kontabilist publik ,jurist ose anëtar i kualifikuar i një profesioni tjetër i cili ndërlidhet ngushtë me me veprimtari afariste të ndërmarrjes Publike .

## **KUSHTET**

*( ndër çështjet tjera të parapara në nenin 17 të Ligjit për Ndermarrjet Publike nr.03/L-087 me plotësim ndryshimet përkatëse me Ligjin nr.04/L-111 dhe Ligjin 05/L-009)*

### **Kandidatët potencial për tu zgjedh në Bordin e Drejtorëve të Ndermarrjes Publike Komunale “Eko-Llapi “Sh.A. Podujevë ,mund të jenë, nëse:**

- Nuk kanë qenë të dënuar dhe nuk jan nën hetime nga ndonjë prej Gjykatave Kompetente;
- Nuk kanë shkelur Kodin e Etikës apo standardet e sjelljes profesionale, përveq nëse ndonjë dënim i tillë është ndryshuar nga Gjykata apo ndonjë organ tjetër i ankesave;
- Nuk kanë bërë përgënjeshtimin e materialit nën çfarëdo dëshmie nën betim;
- Nuk kanë qenë poste menaxheriale në ndonjë kompani të falimentuar në 10 vitet e fundit;
- Nuk punon në ndonjë institucion ku bëhen politika zhvillimore për Ndërmarrjen përkatëse ku kandidati punon.

### **Kandidatët nuk mund të zgjedhen anëtar në Bordin e Drejtorëve, nëse:**

- Aktualisht është zyrtar,menaxher i Ndërmarrjes ose cilëso nga filialet e saj,apo që ka shërbyer si menaxher i kësaj Ndërmarrje ose cilëso nga filialet e saj,5 vitet e fundit;
- Aktualisht ka ,ose gjatë 3 viteve të kaluara ka pasur çfarëdo marrëdhënie materiale – afariste (përveq si konsumator individual i shërbimit të Ndërmarrjes) me Ndërmarrjen Publike Lokale “Eko-Llapi” Sh.A.Podujevë ose cilëso nga filialet,qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë;
- Është aksionar,drejtor,zyrtar ose punonjës i lartë i ndonjë Shoqërie Tregtare apo person tjetër juridik i cili ka marrëdhënie materiale afariste me këtë Ndërmarrje Publike apo cilëso nga filialet e saj;
- Pranon ose ka pranuar brenda 3 viteve të kaluara kompensim shtesë nga kjo Ndërmarrje apo cilëso filiale të saj(përveq honorarit të drejtorit ose kompensimit stimulues të përcaktuar të në nenin 20.1 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike,ose anëtar në skemën pensionale të Ndermarrjes ose cilëso nga filialet e saj;
- Përfaqëson një Aksionar i cili posedon 10% të aksioneve votuese në këtë Ndërmarrje ;
- Ka shërbyer në Bordin e Drejtorëve të kësaj Ndërmarrje më shumë se 9 vite nga zgjedhja e parë e tij, saj;
- Është i afërt i shkallës së tretë (siç është konstatuar në përputhje me përkufizimin e e interesit financiar në nenin 2 të ligjit të cekur) i cilitdo person që i takon cilëso nga nga kategoritë e më sipërme.

- Është zyrtar, drejtor apo aksionar ka interes financiar ,në Shoqëri Tregtare të pa- listuar dhe që konkurren në këtë Ndërmarrje, ose menaxher i lartë, zyrtar, drejtor ose aksionar (i cili posedon më shumë se 2 % të të drejtave të votimit )ose që ka interes të konsiderueshëm financiar me cilëndo nga Shoqëritë Tregtare të listuar që konkurojnë në këtë Ndërmarrje;
- Është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 muajshe para datës së aplikimit ka qenë zyrtar i zgjedhur publik, i emëruar politik, bartës i ndonjë posti udhëheqës ose vendimmarrës në ndonjë prej partive politike të Republikës së Kosovës;
- Ka çfarëdo konflikt të interesit që për nga natyra do të shkarkohet, që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë rutinore ,me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive ti përmbush detyrat e tij fiduciare ndaj aksionarëve në këtë Ndërmarrje.

### **DOKUMENTET E KËRKUARA**

- CV-në;
- Letër motivuese ;
- Deklaratë nën betim (formular që plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit);
- Dëshmitë e kualifikimit profesional;
- Certifikatën që nuk është nën hetim ;
- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës (kopje të pasaportës ose Leternjoftimit).

Aplikuesi/ja duhet të përgatit dhe nënshkruaj deklaratën nën betim, me të cilën deklaron se ai /ajo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësinë dhe përgatitjen profesionale.

Çdo informatë eventuale e pavërtetë materiale, çoftë e qëllimshme ,çoftë nga neglizhenca, do të rezultojë me diskualifikim të menjëhershëm.

Formularët e Aplikimit merren dhe dorëzohen në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë (kati për dhënë) në ndërtesën e re të Komunës, rr. “Nuhi Gashi”, si dhe mund të shkarkohen në webfaqen zyrtare të Komunës së Podujevës.

Dokumentacioni i kompletuar sipas këtij konkursi ,duhet të dorëzohet i mbyllur (në pliko).

**Vëmendje :**



Dokumentacioni dorëzohet në kopje, origjinali duhet të prezantohet gjatë intervistimit. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret sipas këtij konkursi do të kualifikohen për fazat e mëtejme.

Afati i Aplikimit është i hapur 15 ditë pune pas publikimit të shpalljes publike të konkursit, përkatësisht nga 01.12.2023 deri më 25.12.2023

*Komuna e Podujevës - si aksionare e vetme me kapital 100% të aksioneve në Ndërmarrjen Publike Komunale "Eko-Llapi" Sh.A. Podujevë. Komisioni Komunale i Aksionarëve, ofron mundësi te barabarta punësimi për të gjithë qytetarër e Republikës së Kosovës si dhe mirëpret çdo aplikim nga femra dhe meshkuj të të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës.*

**Datë 01.12.2023**

Komisioni

1. Burim Hasani 
2. Bahri Blakçori 
3. Fatlum Osmani 